ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Prishtinë, 29 prill 2014
Kodi i ZRRE-së: V_621_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.6 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit;
- Parimet e Vendosjes së Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar; dhe
- Kërkesën e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A) të datës 06.02.2014 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit "Metodologjia e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar".

Në seancën e mbajtur me datë 29 prill 2014, nxori këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET** METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË NGARKESAVE PËR GJENERATORËT E RREGULLUAR

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) me datë 18.02.2014 ka pranuar kërkesën nga KEK Sh.A. për aprovim të Metodologjisë për Përcaktimin e Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar.
- ZRRE ka qenë e kyçur gjatë tërë kohës së hartimit të dokumentit dhe ka dhënë komentet e veta gjatë takimeve drejtpërdrejt, por dhe në formë të shkruar.
- Zyra e Rregullatorit për Energji me date 19.03.2014 iu ka dërguar për komente Metodologjinë për Përcaktimin e Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar të licencuarve KEDS dhe KOSTT.
- Zyra e Rregullatorit për Energji ka pranuar komentet nga të Licencuarit, dhe pas vlerësimit të tyre dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

III. Obligohet KEK SH.A. që dokumentin Metodologjia e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar, brenda tetë (8) dite pas pranimit, ta publikojë në faqen zyrtare elektronike të saj.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Adresa: Rr. Dërvish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar